

Terma reference

Thirrje për Konsulencë (ekspert /grup ekspertësh)

“Për hartimin e moduleve dhe zhvillimin e trajnimeve për përmirësimin e kapaciteteve të punonjësve që ushtrojnë funksionet e përkujdesit social në Qarkun Korçë”

Konsulenca	Ekspert për hartimin e moduleve dhe zhvillimin e trajnimeve me qëllim ngritjen e kapaciteteve të punonjësve që ushtrojnë funksionet e përkujdesit social në Qarkun Korçë
Projekti	Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit të fëmijëve dhe ndarjes nga familja, shkaktuar nga emergjencat në Shqipëri” zbatuar në partneritet me UNICEF (CO-PRC-2021-004)
Zonat e projektit	Rajonet Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Lezhë, Kukës, Korçë dhe Vlorë
Kohëzgjatja e projektit	Prill – Dhjetor 2021
Lloji i kontratës	Kontratë Shërbimi
Data e fillimit të punës	02 Qershor 2021

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontraktojë **një ekspert ose grup ekspertësh për përgatitjen e moduleve dhe zhvillimit të trajnimit “Hartimi i moduleve dhe Metodologji për ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve përgjegjës për ofrimin e shërbimeve shoqërore në nivel qarku, pjesë e programit “Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit të fëmijëve dhe ndarjes nga familja, shkaktuar nga emergjencat në Shqipëri” zbatuar nga Nisma ARSIS në partneritet me UNICEF dhe me mbështetjen e qeverisë Suedeze.**

Rreth Nisma ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht Nisma) është një organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. Nisma është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i Nisma është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të margjinalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Nisma advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Rreth projektit

Projekti ka si qëllim të ofrojë dhe sigurojë përgjigje ndaj nevojave emergjente në Shqipëri për të reduktuar pasojat e shkaktuara nga tërmetet dhe pandemia e COVID-19, në rajonet e prekura si Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Lezhë, Kukës, Korçë dhe Vlorë. Projekti fokusohet në përpjekjet për të siguruar mbrojtje sociale për grupet në nevojë të prekur nga pasojat e emergjencave të ndodhura në vend. Projekti është në të njëjtën linjë dhe në reagim të koordinuar me masat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare për përgjigjen ndaj pasojave të shkaktuara nga tërmeti dhe pandemia COVID-19, me strukturat në nivel qendror si MSHMS dhe strukturat në nivel lokal në bashkitë e targetuara nga

projekti. Projekti fokusohet jo vetëm në mbështetje të familjeve dhe fëmijëve të prekur nga emergjencat, por edhe pilotimin e shërbimeve të reja mbështetëse për fëmijën dhe familjen, familjet kujdestare profesionale si dhe ngritja e kapaciteteve për punonjësit që janë pjesë e ofrimit të shërbimeve dhe kujdesit social.

Kjo ndërhyrje do të zhvillohet paralelisht dhe në përputhje të plotë me *Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit*, të miratuar në bazë të **VKM-së Nr.706, dt.09.09.2020**, e cila synon të zhvillojë politika, programe dhe shërbime për parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja, fuqizimin e shërbimeve të kujdesit alternativ me bazë familjen dhe transformimin për kalimin gradual nga kujdesi alternativ rezidencial drejt shërbimeve të kujdesit me bazë komunitare për fëmijët dhe familjet e tyre.

Grupet përfituese dhe aktorët kyç:

- Prindër/ kujdestarë të identifikuar në nevojë për mbrojtje ose në nevojë për referim në shërbimet e kujdesit social;
- Fëmijë të vlerësuar në risk të mesëm ose të lartë ndaj shfrytëzimit, dhunës apo abuzimit;
- Fëmijë të vendosur në shërbimet e përkujdesit shoqëror rezidencial;
- Familje me fëmijë në risk për tu institucionalizuar;
- Punonjës të strukturave vendore , përgjegjës për mirëqenien e fëmijëve;
- Punonjës të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

Qëllimi i shërbimit

Qëllimi i shërbimit është hartimi i moduleve dhe zhvillimi i trajnimeve për profesionistët e qeverisjes vendore që ushtrojnë funksionet e kujdesit social me synim rritjen e kapaciteteve të tyre për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve në nevojë për shërbime sociale. Duke qenë se në nevojat e identifikuar në Bashkinë Korçë, vërehet një mungesë e theksuar e profesionistëve si punonjës social, target i trajnimeve do të jenë punonjësit që kryejnë aktualisht funksionet e përkujdesit social në njësitë administrative në Rajonin e Korçës si administratorë shoqërorë, punonjësit e vlerësimit të nevojave dhe referimit, punonjësit e drejtorive të shërbimeve sociale, etj.

Në kuadër të këtij qëllimi, eksperti/grupi i ekspertëve duhet të:

- Hartojnë modulet me tema specifike që përfshijnë shërbimet e mbrojtjes dhe kujdesit shoqëror për prindërit dhe fëmijët me fokus qasjen e menaxhimit të rastit për familjet (të rritur me problematika të ndryshme) për profesionistët e përfshirë në ofrimin e shërbimeve në nivel qarku
- Përcaktojnë Metodologjinë dhe kalendarin e për periudhën e zhvillimit të trajnimeve
- Zhvillojnë ciklin e trajnimeve për profesionistët e përfshirë në ofrimin e shërbimeve në nivel qarku

Metodologjia për përgatitjen e moduleve të trajnimit duhet të realizohet nëpërmjet (1) një rishikimi të detajuar dhe të kujdesshëm të praktikave më të mira, manualeve, udhëzimeve, që lidhen me menaxhimin e rasteve për të gjitha kategoritë në nevojë, me fokus mënyrën e identifikimit, referimit, vlerësimit dhe ndjekjes dhe (2) zhvillimit të trajnimeve për të profesionistët e përfshirë në ofrimin e shërbimeve në nivel qarku të cilët nuk kanë formimin e punonjësve sociale, duke siguruar pjesëmarrje aktive përgjatë gjithë procesit të trajnimit.

Detyrat

Si pjesë e kësaj ekspertize, Eksperti/grup i ekspertëve i përzgjedhur duhet të realizojë :

- 1- Përgatitjen e moduleve dhe kornizën e trajnimit për profesionistët e qeverisjes vendore të cilët ushtrojnë funksionet e kujdesit social (8 ditë pune)**

- Përgatitja e Moduleve të trajnimit duhet të jenë të përshtatura edhe për të mësuarin online. Temat e trajtuara duhet të jenë të lidhura me tipologjinë e shërbimeve shoqërore si shërbimet parashoqërore, shërbimet në komunitet dhe shërbimet e kujdesit alternativ.
 - a) Shërbimi në familje;
 - b) Shërbimi i përkujdesjes alternative;
 - c) Shërbimi multifunksional;
 - d) Shërbimi në qendrat ditore;
 - e) Shërbimi i emergjencës;
 - f) Shërbimi për të pastrehët;
 - g) Shërbimi i strehimit të mbrojtur;
 - h) Shërbime në qendrat e zhvillimit;
 - i) Shërbimi në strehëza;
 - j) Shërbimet e specializuara.
- Menaxhimit i rasteve të fëmijëve, të rinjve dhe prindërve.
- Mënyra e funksionimit të mekanizmit të bashkëveprimit për menaxhimin dhe trajtimin e rasteve;
- Përdorimi i informacionit mbi shërbimet në territor dhe nivel qarku, specifiki shërbimet e ofruara nga QSHMFF si dhe bazuar në hartën e shërbimeve.
- Modulet e trajnimit duhet të përfshijnë çështje që trajtojnë dhunën me bazë gjinore apo prespektiva të tjera të dëmshme të cilat ndikojnë në jetën e fëmijës dhe familjes, të lidhura ngushtë edhe me kontekstin e emergjencave civile që po përjetohej.

2- Zhvillimin e trajnimeve për profesionistët e qeverisjes vendore të cilët ushtrojnë funksionet e kujdesit social (45 ditë pune - 3 grupe profesionistësh nga 15 anëtarë * 15 ditë trajnimi)

Shënim: Eksperti/grup ekspertëve duhet të jenë fleksibël për ndryshimet e mundshme kufizuese të lidhura me Pandeminë COVID-19.

Eksperti/grupi i ekspertëve duhet të dorëzojë:

- a) Modulet dhe korniza e trajnimit;
- b) Metodologjia dhe kalendari i trajnimit;
- c) Raportin dhe vlerësimin e trajnimit (pretest, post test, vlerësim);

Afatet kohore

Aktivitete	Afati
Dorëzim i Modulit dhe Metodologjisë	Qershor 2021
Dorëzimi Kalendarit dhe Kornizës së trajnimit	Qershor 2021
Trajnimi i profesionistëve	Korrik-Nëntor 2021
Raporti dhe vlerësimi i trajnimit	Nëntor 2021

Kualifikime dhe eksperiencia e punës:

- Diplomë universitare e ndërthurur me trajnime të specializuara në fushën e shkencave sociale.
- Njohuri shumë të mira dhe eksperiencë të mëparshme në hartimin e moduleve, udhëzuesve të shërbimeve shoqërore.
- Njohuri shumë të mira të paketës ligjore të shërbimeve shoqërore.

- Njohuri shumë të mira të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020-2023 dhe të gjithë paketës ligjore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- Më tepër se 5 vite eksperiencë profesionale si ekspert, dhe praktikë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, kryesisht në menaxhimin e rasteve dhe fuqizimin e familjeve në situatë vulnerabël;
- Përvojë me koordinimin e veprimeve për realizimin e raporteve, manualeve dhe analizave në fushën e mbrojtjes sociale.

Politikat e Mbrojtjes: Të gjithë personat që punojnë me programet e NISMA janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes bashkëngjitur me termat e referencës.

Koha e e mundshme e fillimit të punës është 2 Qershor 2021
Kjo ekspertizë përfshin 53 ditë punë

Procedura e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dërgojnë me email:

- 1- Shprehje interesi
- 2- Curriculum Vitae (evidence të punëve të mëparshme të ngjashme);
- 3- Draft të parë të metodologjisë së propozuar bashkë me planin e punës;
- 4- Oferta financiare (të gjitha taksat përfshirë)
- 5- Taksa e rregjistrimit (nëse disponohet)
- 6- Deklaratë e disponueshmërisë dhe angazhimit për të ndërmarrë dhe përfunduar shërbimet në kuadër të kësaj konsulence brenda afateve kohore

Gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet në adresën e emailit: initiative.arsis@gmail.com deri në datën 31 Maj 2021, mesnatë, me subjekt : Aplikimi për ***“Ekspert për hartimin e moduleve dhe zhvillimin e trajnimeve për përmirësimin e kapaciteteve të punonjësve që ushtrojnë funksionet e përkujdesit social në Qarkun Korçë.***

Procedura e Vlerësimit

Përzgjedhja e ekspertit/grupit të ekspertëve do të bazohet në: se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës, bazuar në kualifikimet, eksperiencat e mëparshme, ofertën financiare si në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
Kualifikime	20%
Eksperiencë pune	50%
Oferta financiare	30%

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për pozicionin e Ekspertit/es/grup ekspertësh do të kontaktohen.